



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARE

**Lindita NIKOLLA**

**REZOLUTË**

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË  
PËR VITIN 2021**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke vlerësuar rolin e Bankës së Shqipërisë në mbikëqyrjen e sistemit financiar të vendit dhe nxitjen e rritjes së qëndrueshme të ekonomisë;

Duke vlerësuar pavarësinë institucionale të Bankës së Shqipërisë në raport me ligjin, si dhe detyrimin për zbatimin dhe raportimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë;

Duke vlerësuar angazhimin e Bankës së Shqipërisë për zbatimin e objektivave dhe detyrimeve të saj ligjore,

**Vlerëson veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2021 për përmbushjen e funksioneve të saj dhe të objektivave strategjike afatmesëm në këto drejtime:**

Ndjekjes në vazhdimësi të një politike monetare lehtësuese, të koordinuar mirë me politikën fiskale në drejtim të nxitjes së rimëkëmbjes ekonomike, duke zgjatur në kohë masat e ndërmarra gjatë pandemisë, që përfshinin mosndryshimin e normës bazë të interesit në 0.5% dhe furnizimin e pakufizuar me likuiditet të sistemit financiar.

Përmirësimit më tej të politikave të saj në drejtim të zgjerimit dhe përmirësimit të cilësisë së portofolit të kredisë me rritje mesatare prej 8.4%, si dhe rënien e raportit të kredive me probleme ndaj totalit, i cili për vitin 2021 rezultoi në 5.65% nga 8.11% që ishte në vitin 2020, duke shënuar nivelin më të ulët në dekadën e fundit.

Intensifikimit të punës për përmirësimin e kuadrit rregullativ mbikëqyrës për përafrimin me praktikatat më të mira europiane dhe parimet e Komitetit të Bazelit, i cili rrit transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare në favor të informimit të plotë të huamarrësit, si dhe synon të sigurojë praktika të drejta në treg në lidhje me nivelin e normave të interesit,

komisioneve dhe penaliteteve të aplikuara, sidomos nga subjektet financiare jobanka për produktet e kredisë.

Rritjes së numrit të inspektimeve, veçanërisht për çështjet e financimit të terrorizmit dhe kontrollin e transaksioneve ndërkombëtare për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Komiteti Moneyval, me fokus subjektet financiare jobanka dhe zyrat e këmbimit valutë duke realizuar një numër total prej 109 inspektimesh.

Forcimit të mëtejshëm të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik nëpërmjet realizimit të 14 ekzaminimeve të plota dhe të pjesshme në sektorin bankar, të cilat janë përqendruar kryesisht në riskun e kredisë, por duke mos anashkaluar edhe aspekte të tjera të rëndësishme të veprimtarisë bankare, si rreziku operacional dhe i teknologjisë së informacionit, si dhe rreziqet financiare

Ushtrimin të kompetencave të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme nëpërmjet përfundimit të ciklit të plotë të hartimit të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankat sistemike dhe josistemike dhe fuqizimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në banka dhe monitorimit të vazhdueshëm të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Sigurimit të funksionimit normal të sistemeve të pagesave me vlerë të madhe (AIPS) dhe atyre me vlerë të vogël (AECH), të cilat kanë performuar me rritje vjetore si në numër dhe në vlerë transaksionesh në krahasim me vitin 2020, si dhe përfundimin e dy projekteve të rëndësishme infrastrukturore: për shërbimet e pagesave për debitimin direkt ndërbankar dhe për kryerjen e pagesave ndërbankare në euro brenda vendit për klientët e bankave, duke shmangur bankat korrespondente, të cilat sjellin përfitime të mëdha për konsumatorin, nëpërmjet krijimit të fleksibilitetit, uljes së ndjeshme të kostove dhe rritjes së aksesit në shërbimet e pagesave, si dhe mundësitë të integritit të sistemeve të pagesave në tregun europian të pagesave (SEPA).

Përmbushjes së objektivave të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël 2021-2023 për rritjen e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave me 20.6% më shumë se në vitin 2020 dhe rritjes së volumit të pagesave, vlerës së transaksioneve dhe të transfertave të kreditit në formë elektronike “*home banking*”, duke krijuar premisa për krijimin e një tregu modern dhe gjithëpërfshirës në interes të popullatës.

Përmbylljes me sukses të procesit për hedhjen në qarkullim të serisë së re me kartëmonedhat e prerjes 1000 lekë dhe 10 000 lekë, pajisjen e tyre me elemente bashkëkohore dhe të sofistikuar sigurie, si dhe plotësimit të kuadrit rregullator të mbrojtjes së monedhave nga falsifikimi nëpërmjet miratimit të dy rregulloreve të reja, si dhe nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Bankën Qendrore Europiane për mbrojtjen e euros nga falsifikimi.

Administrimit të rezervës valutore në përputhje me politikën e administrimit, ku objektivi parësor është parimi i likuiditetit dhe ai i sigurisë, ku për vitin 2021 rezerva valutore është rritur me rreth 1 miliard euro, ose dyfishi i rritjes së vitit 2020, duke regjistruar në fund të muajit dhjetor vlerën 4.97 miliardë euro, nivel ky në përputhje me kriteret për mjaftueshmërinë e rezervës.

Standardizimit dhe unifikimit të statistikave të prodhuara sipas standardeve ndërkombëtare, me fokus statistikat monetare, si dhe përfundimin e projektit dyvjeçar për hartimin e treguesve të zbalancimeve makroekonomike (MIP).

Rritjes së transparencës, përmirësimit të komunikimit me publikun dhe edukimin ekonomik dhe financiar.

### **Kuvendi kërkon që Banka e Shqipërisë për vitin 2022 të angazhohet në këto drejtime:**

Ruajtjes së qëndrueshmërisë së sistemit financiar nëpërmjet monitorimit të kujdesshëm të efekteve të tregjeve ndërkombëtare, krijimit të kushteve për nxitjen e kreditimit të shëndetshëm të ekonomisë, adoptimit të mëtejshëm të të gjitha praktikave dhe standardeve relevante të Bazel

II dhe Bazel III, konvergimit më standardet europiane dhe marrjen e certifikimeve të mëtejshme në fushën e mbikëqyrjes nga Banka Qendrore Europiane.

Zbatimit të politikës monetare që mbështet rimëkëmbjen ekonomike dhe harmonizohet me procesin e konsolidimit fiskal, në interes të rritjes së qëndrueshmërisë fiskale dhe financiare të vendit nëpërmjet përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së analizave ekonomike e financiare, rritjen e saktësisë së parashikimeve dhe plotësimin e tyre me skenarë alternativë dhe/ose rreziku.

Përmirësimit të proceseve të zbatimit të politikës makroprudenciale nëpërmjet miratimit të kuadrit nënligjor për instrumentet që vendosen mbi huamarrësin dhe ushtrimin të provës së rezistencës për qëllime makroprudenciale, përfshirë ndjeshmërinë ndaj ndërlikohjes së sektorit bankar me sektorë të tjerë të sistemit financiar dhe ekonomisë.

Monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë së portofolit të kredisë, me fokus të veçantë kreditimin në tregun e pasurive të paluajtshme, me qëllim identifikimin dhe menaxhimin në kohë të problematikave.

Monitorimit dhe mbështetjes për fuqizimin e aftësisë së bankave për ndërhyrje të jashtëzakonshme përmes një komunikimi aktiv dhe me inspektime të rregullta, me qëllim operacionalizimin e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, sipas kërkesave të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, si dhe për përmbylljen brenda vitit 2022 të procesit të vetëvlerësimit të bankave për të trajtuar pengesat potenciale të identifikuar, bazuar në objektivat e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme të përcaktuara në kuadrin rregullator në fuqi.

Intensifikimit të përpjekjeve për krijimin e një tregu modern e gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël, të mbështetur nga infrastruktura të sigurta dhe efikase, si dhe nga një gamë e gjerë instrumentesh dhe shërbimesh të pagesave që përmbushin nevojat e përdoruesve të tyre, të aftë financiarisht, në të gjithë vendin.

Intensifikimit të bashkëpunimit me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Agjencinë e Sigurimit të Depozitave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave duke u përqendruar në kryerjen e ekzaminimeve të përbashkëta në subjektet e mbikëqyrura.

Analizimit të pengesave për zhvillimin e mëtejshëm të tregut ndërbankar të parasë me qëllim identifikimin e pikave të dobëta dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse.

Të ketë në vëmendje ruajtjen e fondit të rezervës nëpërmjet mbajtjes nën kontroll në një mënyrë sa më të kujdesshme të rrezikut të likuiditetit, të tregut, të kreditit ligjor, të shlyerjes, të kujdestarisë dhe atij operacional, duke u angazhuar në gjenerimin e të ardhurave të arsyeshme në periudhën afatmesme në afatgjatë, në përputhje me objektivat e investimit dhe administrimit të rreziqeve, për sa kohë që kjo nuk bie ndesh me kriteret e likuiditetit dhe sigurisë të përcaktuara më sipër.

Administrimit të portofolit të rezervës valutore në përshtatje me nevojat për një diversifikim të portofolit përmes shtimit të klasave të reja të instrumenteve financiare.

Në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe FMN-në t'i kushtojë vëmendje aktivitetit të institucioneve financiare jobanka dhe konvergimit të standardeve dhe praktikave të tyre rregullatore me ato të sektorit bankar, me qëllim promovimin e efikasitetit të sistemit financiar dhe konkurrencën e ndershme brenda dhe ndërmjet segmenteve të ndryshme të tij.

Bashkëpunimit midis institucioneve të tjera rregullatore për shkëmbim të informacionit, si dhe vijimin e punës për reduktimin e përdorimit të monedhës së huaj në vend, duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve publikë dhe privatë për rreziqet që ajo sjell, si dhe duke synuar forcimin e përgjegjësive së institucioneve shqiptare.

Angazhimit në drejtim të nxitjes e formalizimit të ekonomisë, edukimit dhe përfshirjes financiare.

Të inkurajojë vijimin e transformimit digjital të sektorit bankar, duke mundësuar një bashkëpunim të frytshëm dhe novator mes bankave të nivelit të dytë dhe kompanive FinTech, duke sugjeruar e këshilluar institucionet dhe agjencitë shtetërore për të luajtur një rol më

proaktiv në plotësimin e kërkesave që shtrojnë zhvillimet e përdorimit të teknologjisë së informacionit.

Të inkurajojë implementimin e Open Banking, PSD2 (*Payment Service Directive EU*), si dhe mundësimin për shtimin e opsioneve për transferim parash dhe pagesat bankare me qëllim uljen e kostove në çdo transaksion.

Të inkurajojë mundësimin dhe lehtësimin e çeljeve të llogarive bankare për individët që nuk disponojnë aktualisht një të tillë dhe që përbëjnë rreth 45% të popullsisë, duke shfrytëzuar avantazhet e teknologjisë së informacionit.

Miraturar në datën 16.6.2022